



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Në bazë të nenit 38, paragrafi 2, neni 94, neni 104 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO			
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE			
REGULATIVNI AUTORITET ŽELEZNICA			
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY			
DEP/SEK:	01	NR PROT:	266
DEP/SEK:		BR PROT:	
DEP/SEK:		NR PROT:	
NUMRI I FALCËVË	21	DD.MM.YYYY:	25/09/2018
ANUJ STRANA		DD.MM.YYYY:	
NR. OF PAGES		DD.MM.YYYY:	
PRISHTINE / A			

Rregullore Nr.06-2018 për Përdorimin e një Formati të Përbashkët Evropian për Certifikatat e Sigurisë, dokumentet e aplikimit dhe vlefshmëria e Certifikatave të Sigurisë

Rr. Rustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton formatin e përbashkët Evropian për certifikatat e sigurisë si dhe dokumentet e aplikimit të cilat duhet të dorëzohen të organi i sigurisë nga ana e ndërmarrjeve hekurudhore. Në formulat të aplikimit janë të sqaruar kërkesat të cilat duhet të përmbushen me qëllim marrjen e certifikatës së sigurisë pjesa A dhe B.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për të gjithë operatorët hekurudhor të cilët operojnë ligjërisht brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Neni 3

Definicionet

Për qëllimet e kësaj Rregullore, do të zbatohet përkufizimi i mëposhtëm:

"shpejtësi e lartë", nënkupton linja të posaçme të ndërtuara dhe të pajisura për shpejtësi të lartë, ku zhvillohet shpejtësi e barabartë ose më e madhe se 250 km / h, siq është përcaktuar në Shtojcën I të Direktivës m Nr. 96/48/EC.

"mallra të rrezikshme", nënkupton masat e aplikuara nga organi i sigurisë për të mbikëqyrur transportin e materieve të rrezikshme, siq është përcaktuar në Direktivën Nr. 96/49/EC.

"madhësia e ndërmarrjes", nënkupton numrin e parashikuar të punësuarve, ku në aplikacion mund të zgjedhën opsionet (2.16, 2.17, 2.18 dhe 2.19).

Neni 4

Formulari i aplikimi për certifikatë të sigurisë

Për të aplikuar për certifikatë të sigurisë pjesa A dhe B, aplikuesi duhet të përdor formularin e aplikimit të ofruar nga ana e jonë, ky formular mund të gjendet në faqen tonë të internetit www.arh-ks.org.

Organi i sigurisë do ju njoftojë për marrjen e aplikacionit tuaj brenda 48 orëve nga momenti i protokollimit në ARH.

Neni 5

Certifikatat e sigurisë të lëshuara në përputhje me Nenin 94, nenin 104 (3) të Ligjit 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës, si dhe Nenin 10 (2) (a) të Direktivës 2004/49 / EC (Certifikata Pjesa A) duhet të përdorin formatin standard siç është përcaktuar në Shtojcën I të kësaj Rregullore.

Ky format do të përdoret sa herë që të lëshohet, rinovohet, përditësohet, ndryshohet ose revokohet certifikata e sigurisë Pjesa A.

Neni 6

Certifikatat e sigurisë të lëshuara në përputhje me Nenin 94, nenin 104 (3) të Ligjit 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës, si dhe Nenin 10 (2) (a) të Direktivës 2004/49 / EC (Certifikata Pjesa B) duhet të përdorin formatin standard siç është përcaktuar në Shtojcën II të kësaj Rregullore.

Ky format do të përdoret sa herë që të lëshohet, rinovohet, përditësohet, ndryshohet ose revokohet certifikata e sigurisë Pjesa B.

Neni 7

Aplikimet për Pjesën A dhe/ose Pjesën B, të certifikatave të dorëzuara në përputhje me Nenet 10 dhe 12 të Direktivës 2004/49 / EC duhet të jenë në formatin standard të paraqitur në Shtojcën III të kësaj Rregullore.

Formulari i aplikimit duhet të plotësohet në bazë të udhëzimeve të përshkruara në Shtojcën III të kësaj Rregullore.

Neni 8

Çdo certifikatë e sigurisë duhet ti jepet një numër unik, në përputhje me protokollin e përshkruar në Aneksin IV të kësaj Rregullore.

Neni 9

Organi përgjegjës për çështje të sigurisë duhet ta informoj ministrinë brenda një muaji për certifikatën që është lëshuar, përtërirë, korrigjuar apo revokuar. Aty duhet të thuhet emri dhe adresa e ndërmarrjes hekurudhore, data, fushë përfshirja dhe vlefshmëria e certifikatës së sigurisë dhe në rast të revokimit arsyet për atë vendim.

Lëshimi, rinovimi, ndryshimi ose revokimi i të gjitha certifikatave të sigurisë së Pjesës A dhe B, duhet të bëhet në përputhje me Nenin 94, nenin 104 (3) të Ligjit 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës, si dhe Nenin 10 (2) (a) të Direktivës 2004/49 / EC.

Neni 10

Amendamentimi, azhurnimi ose rinovimi i një certifikate të sigurisë të lëshuar sipas Direktivës 2001/14 / EC do të bëhet në përputhje me këtë Rregullore, Ligjin 04/L-063 dhe Direktivën 2004/49 / EC. Çdo ndërmarrje hekurudhore që tashmë ka një certifikatë sigurie të dhënë sipas Direktivës 2001/14 / EC, ka të drejtë që të kërkojë nga organi i sigurisë një certifikatë të re të sigurisë të lëshuar në përputhje me këtë Rregullore, Ligjin Nr. 04/L-063 dhe Direktivën 2004/49 / EC.

Neni 12
Transpozimi

Kjo rregullore transponon rregulloren e BE-së me Nr. 653/2007/EU.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Arsim Berisha
Kryesues i Bordit
Prishtinë: xx/xx/2018

SHTOJCA I

CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA A

Certifikata e Sigurisë që konfirmon pranimin e Sistemit të Menagjimit të Sigurisë në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat në Republikën e Kosovës, udhëzimin përkatës administrativ 04/2012 rregulloren xx/2018, si dhe në përputhje me Direktiven 2004/49/KE

Nr. Identifikues:

1. NDËRMARRJA E CERTIFIKUAR HEKURUDHORE

Emërtimi Ligjor:	
Emri i operatorit hekurudhor:	Shkurtesë:
Nr. i Biznesit:	Nr. i Tvsh:

2. CERTIFIKATA E LËSHUAR NGA INSTITUCIONI

Institucioni:
Shteti:

3. INFORMATAT E CERTIFIKATËS

Kjo është një:	-Certifikatë e re	☐	Numri i identifikimit të Certifikatës së me parshme:
	-Certifikatë e rinovuar	☐	
	-Certifikatë e ndryshuar	☐	
E vlefshme nga:		Deri:	
Lloji i shërbimeve:			
Vëllimi i transportit:			
Madhësia e ndërmarrjes hekurudhore:			

4. LEGJISLACIONI NACIONAL NË FUQI

--

5. INFORMATAT SHITESË

--

Data e lëshimit

--

Numri i bëndshëm i referencës

--

Emri:

Nënskrimi: _____
Vula e Autoritetit

SHTOJCA II

CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA B

Certifikata e Sigurisë që konfirmon pranimin e dispozitave të miratuara për ndërmarrjet hekurudhore me qëllim përmbushjen e kërkesave specifike për operim të sigurt në rrjetin përkatës në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat në Republikën e Kosovës, udhëzimin përkatës administrativ 04/2012, rregulloren xx/2018, si dhe në përputhje me Direktiven 2004/49/KE

Nr. Identifikues:

1. NDËRMARRJA E CERTIFIKUAR HEKURUDHORE

Emërtimi Ligjor:	
Emri i operatorit hekurudhor:	Shkurtesë:
Nr. i Biznesit:	Nr. i Tvsh:

2. CERTIFIKATA E LESHUAR NGA INSTITUCIONI

Institucioni:	
Shteti:	

3. INFORMATAT E CERTIFIKATËS

Kjo është një:	-Certifikatë e re	☐	Numri i identifikimit të Certifikatës së më parshme:
	-Certifikatë e rinovuar	☐	
	-Certifikatë e ndryshuar	☐	
E vlefshme nga:		Deri:	
Lloji i shërbimeve:			
Vëllimi i transportit:			
Madhësia e ndërmarrjes hekurudhore:			

4. CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA A (Pranimi i Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë)

Numri i Identifikimit:	
------------------------	--

5. LINJAT E OPERIMIT

--	--

6. KUSHTET E VEÇANTA DHE DETYRIMET

--	--

7. LEGJISLACIONI NACIONAL I APLIKUESHËM

--	--

Data e lëshimit

Numri i bëndshëm i referencës

Emri:

Nënshkrimi:

Vula e Autoritetit

SHTOJCA III

Formulari standard i aplikimit dhe udhëzimet

APLIKACIONI PËR CERTIFIKATË TË SIGURISË

Aplikacioni për Certifikatë të Sigurisë që konfirmon pranimin nga ndërmarrjet hekurudhore të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë- Certifikata e Sigurisë (Pjesa A)- dhe/ose konfirmon pranimin e dispozitave të miratuara për ndërmarrjet hekurudhore me qëllim përmbushjen e kërkesave specifike për operim të sigurt në rrjetin përkatës- Certifikata e Sigurisë (Pjesa B)- në përputhje me Direktiven 2004/49/KE dhe legjislacionit Kombëtar në fuqi.

NUMRI I REFERENCËS TË AUTORITETIT TË SIGURISË

ORGANI I SIGURISË/AUTORITETI INFORMATAT PËR KONTAKT

- 1.1. Organi i sigurisë/autoriteti që i drejtohet kërkesa
1.2. Adresa e plotë postare(Rruga, kodi postar, qyteti, shteti)

2.1. Ky aplikacion është për CERTIFIKATËN-PJESA-A

- 2.2. Certifikatë e re ☐ 2.4. Certifikatë e ndryshuar ☐
2.3. Certifikatë e përsëritur ☐ 2.5. Numri i identifikimit të ☐

Certifikatës së me parshme Pjesa-A

Llojet e shërbimeve të kërkuara (zgjidhni një ose me shumë) dhe vëllimi i parashikuar i mallërave/udhëtarëve

- 2.6. Duke përfshirë shërbimet e shpejtësisë së lartë ☐ 2.8. Më pak se 200 milion udhëtarë-km për vitë ☐

Transporti i udhëtarëve

- 2.7. Duke përjashtuar shërbimet e shpejtësisë së lartë ☐ 2.9. 200 milion ose me shumë udhëtarë-km për vitë ☐

- 2.10. Duke përfshirë shërbimet për mallëra të rrezikshme ☐ 2.12. Më pak se 500 milion ton-km për vitë ☐

Transporti i mallrave

- 2.11. Duke përjashtuar shërbimet për mallëra të rrezikshme ☐ 2.13. 500 milion ose më shumë ton-km për vitë ☐

- 2.14. Vetëm tërheqje ☐

- 2.15. Shërbimet të fillojnë më

Ndërmarrja hekurudhore që paraqet kërkesë për aplikim i takon kategorisë së më poshtme për numrin e parashikuar të punësuarve

- 2.16. Mikro ndërmarrje ☐ 2.18. Ndërmarrje të mesme ☐
2.17. Ndërmarrje e vogël ☐ 2.19. Ndërmarrje të mëdha ☐

3.1. Ky aplikacion është për CERTIFIKATËN-PJESA-B

- 3.2. Certifikatë e re ☐ 3.4. Certifikatë e ndryshuar ☐
3.3. Certifikatë e përsëritur ☐ 3.5. Numri i identifikimit të ☐

Certifikatës së me parshme Pjesa-B

Llojet e shërbimeve të kërkuara dhe vëllimi i parashikuar i mallërave/udhëtarëve në rrjetin ku pjesa B do të aplikohet (një apo më shumë të zgjidhen)

3.6. Duke përfshirë shërbimet e shpejtësisë së lartë

☐

3.8. Më pak se 200 milion udhëtarë-km për vitë

☐

Transporti i udhëtarëve

3.7. Duke përjashtuar shërbimet e shpejtësisë së lartë

☐

3.9. 200 milion ose më shumë udhëtarë-km për vitë

☐

3.10. Duke përfshirë shërbimet për mallëra të rrezikshme

☐

3.12. Më pak se 500 milion ton-km për vitë

☐

Transporti i mallërave

3.11. Duke përjashtuar shërbimet për mallëra të rrezikshme

☐

3.13. 500 milion ose më shumë ton-km për vitë

☐

3.14. Vetëm tërheqje

☐

3.15. Shërbimet të fillojnë më:

3.16. Linjat në të cilat mendohet të operohet

Nëse aplikuesi tashmë e ka një Certifikatë valide pjesa-A (pranimin e Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë) ai duhet të japë informacionin e mëposhtem.

3.17. Numri i identifikimit të certifikatës së sigurisë-Pjesa-A

3.18. Shteti në të cilin është lëshuar certifikata e sigurisë-Pjesa-A

NËSE APLIKUESI TASHMË KA NJË (OSE MË SHUMË) CERTIFIKATË VALIDE PJESA-B, AI DUHET TË JAPË INFORMACIONIN E MËPOSHTEM.

4.1. Numri i identifikimit të certifikatës së lëshuar të sigurisë-Pjesa-B

NËSE APLIKUESI KA NJË LICENCË DHE ËSHTË DUKE APLIKUAR PËR PJESËN-A DHE/OSE PJESËN-B TË CERTIFIKATËS AI DUHET TË JAPË INFORMACIONIN E MËPOSHTEM.

4.2. Numri i njoftimit të Licencës

4.3. Shteti në të cilin është lëshuar Licenca

INFORMATAT E APLIKUESIT

5.1. Emërtimi Ligjor

5.2. Emri i ndërmarrjes hekurudhore

5.3. Shkurtesa

5.4. Adresa e plotë postare (Rruga, kodë postar, qyteti, shteti)

5.5. Numri i telefonit

5.6. Numri i fax-it

5.7. e-mail adresa

5.8. Web- faqja

5.9. Numri nacional i regjistrimit

5.10. Numri i Tvsh

5.11. Informata të tjera

Informatat e përsoneit kontaktuës

- 6.1. Mbiemri dhe emri
- 6.2. Adresa e plotë postare (Rruga, kodi postar, qyteti, shteti)
- 6.3. Numri i telefonit..... 6.4. Numri i fax-it
- 6.5. e-mail adresa
-

Aplikuesi:
(Emri dhe Mbiemri)

Data:

Nënshkrimi:

Numri i brendshëm i referencës:

Data e pranimit të aplikacionit:

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Adresa: Rr.Rrustem Statovci, 29
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 22 00 40 ext
Fax: +381 38 22 33 40
Ueb: www.arh-ks.org

FAQJA E PARË PËR SHITESAT(ANEKSET) NË FORMULARIN E APLIKACIONIT

DOKUMENTET E PARAQITURA PËR

PJESA-A

7.1. ☐ Përmbledhje e manualit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë siç i referohet nenit 9. dhe shtesës III të Direktivës 2004/49/KE

7.2. ☐ Kopja e licencës (Nëse aplikohet)

7.3. ☐ Nuk aplikohet

PJESA-B

8.1. ☐ Kopja e certifikatës pjesa-A

8.2. ☐ Kopja e licencës (Nëse aplikohet)

8.3. ☐ Nuk aplikohet

8.4. ☐ Kopja e sigurimit ose mbulesës financiare për përgjegjësi, shtesa e licencës

8.5. ☐ Lista e rregullave të domosdoshme dhe STI-së(TSI) duke ju referuar procesit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë dhe dokumenteve se si ato janë implementuar

8.6. ☐ Lista e kategorive të ndryshme të personelit, të punësuar ose kontraktuar

8.7. ☐ Përshkrimi i personelit lidhur me procesin e Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë, të kerkuar sipas rregullave nacionale ose STI-së(TSI) dhe referimi në certifikatat nacionale kurë është e nevojshme

8.8. ☐ Lista e llojeve të ndryshme të mjeteve lëvizëse

8.9. ☐ Përshkrimi i mjeteve lëvizëse lidhur me procesin e Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë, të kerkuar sipas rregullave nacionale ose STI-së(TSI) dhe referimi në certifikatat nacionale kurë është e nevojshme

8.10. ☐ Të tjera (Specifiko)

Aplikuesi:
(Emri dhe Mbiemri)

Data:

Nënshkrimi:

Numri i brendshëm i referencës:

Data e pranimit të aplikacionit:

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Adresa: Rr.Rrustem Statovci, 29
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 22 00 40 ext
Fax: +381 38 22 33 40
Ueb: www.arh-ks.org

UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E APLIKIMIT

Informacioni që duhet të futet në Formularin e Aplikimit për Certifikatat e Sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B

HYRJJE

Ky Formular i Aplikimit duhet të përdoret nga ndërmarrjet hekurudhore (gjithashtu të referuara si 'aplikuësi') për të aplikuar për një Certifikatë të Sigurisë Pjesa A dhe/ose Pjesa B, Nenin 94 i Ligjit 04/L-063, për hekurudhat në Republikën e Kosovës, Neni 10 (1) – i Direktivës 2004/49 / EC. Referencat në këtë dokument janë bërë, përveç nëse përmenden ndryshe, tek nenet në Ligjin 04/L-063 dhe Direktivën 2004/49 / EC.

Një ndërmarrje hekurudhore që aplikon për njërin prej këtyre certifikatave ose për të dyja mund ta përdorë këtë formular aplikimi për ta përcjellë kërkesën e tij tek organi kompetent për dhënien e certifikatës së sigurisë. Përdorimi i tij do t'i mundësojë organit të sigurisë që të përpunojë kërkesën pa vonesa të panevojshme dhe megjithatë brenda afateve të përcaktuara në nenin 19 (3) të Ligjit 04/L-063, si dhe nenin 12 (1) të Direktivës 2004/49/EC.

Të gjitha fushat në formular duhet të plotësohen me informatat e ofruara nga ndërmarrja hekurudhore.

Certifikata e Sigurisë pjesa A dhe pjesa B

Ky dokument lejon një ndërmarrje hekurudhore të aplikojë në të njëjtën kohë për të dyja Certifikatat Pjesa A dhe B ose vetëm për njërin prej tyre, duke përdorur të njëjtin formular ndërmarrja hekurudhore mund të kërkojë një certifikatë të re, rinovuar ose përditësuar/ndryshuar të Pjesës A dhe/ose B Pjesa (siç përcaktohet në nenin 10 (5) të Direktivës 2004/49/EC).

Ekziston mundësia që të aplikohet vetëm për një Certifikatë të Pjesës A dhe, me një aplikim të dytë, më vonë për Certifikatën Pjesa B.

Nëse aplikohet vetëm për Certifikatën e Pjesës B, ndërmarrja hekurudhore duhet paraprakisht të jetë e pajisur me një Certifikatë të vlefshme të sigurisë Pjesa A.

Lloji dhe shtrirja e operimeve hekurudhore

Sipas Nenit 10 (5) të Direktivës 2004/49/EC, Certifikata e Sigurisë do të përditësohet tërësisht ose pjesërisht kurdo që lloji ose shtrirja e operimit të ndryshohet ndjeshëm, në këtë rast mbajtësi i certifikatës pa vonesë duhet të informojë organin e sigurisë për të gjitha ndryshimet kryesore në kushtet e pjesës përkatëse të Certifikatës së Sigurisë. Prandaj është e rëndësishme që organi i

sigurisë të dijë të përcaktojë "llojin" dhe "shtrirjen" e shërbimeve hekurudhore që do i ketë një ndërmarrje hekurudhore.

"Lloji" dhe "shtrirja" formojnë bazën për vlefshmërinë e Certifikatës Pjesa A dhe japin referencë për të definuar "operime të barabarta të transportit hekurudhor" (Neni 10 (3) të Direktivës 2004/49/EC) në të gjithë Komunitetin e transportit hekurudhor.

'Lloji' i shërbimit karakterizohet me transportin e udhëtarëve, duke përfshirë dhe përjashtuar shërbime me shpejtësi të lartë, transportin e mallrave, duke përfshirë dhe duke përjashtuar shërbimet e mallrave të rrezikshme, si dhe shërbime vetëm të manovrimit.

'Shtrirja' e shërbimit të ndërmarrjes hekurudhore karakterizohet nga vëllimi i transportit të udhëtarëve / mallrave dhe madhësia e parashikuar e ndërmarrjes hekurudhore sa i përket punonjësve që punojnë në sektorin hekurudhor (mikro, ndërmarrje të vogla, të mesme dhe të mëdha).

"Lloji" dhe "shtrirja" e shërbimeve për të gjitha Certifikatat e Pjesës B, të kryera në mënyrë globale nga e njëjta ndërmarrje hekurudhore në një ose më shumë Shtete, duhet të mbulohen nga "lloji" dhe "shtrirja" e shërbimeve të Certifikatës Pjesa A.

Të gjitha informatat e përfshira në fushat 2.6 deri 2.19 dhe 3.6 deri 3.16, të kësaj rregullore janë të nevojshme për të përcaktuar nëse synohet që shërbimet e operimit me Certifikatën e Sigurisë të kërkuar janë të barasvlershme ose jo me operimet e tjera të transportit hekurudhor të kryera tashmë nga aplikuesi me certifikatën valide të mëparshme të cilën e ka pasur ndërmarrja hekurudhore.

INFORMACION SHITESË

Faqja e tretë e formularit të aplikimit është menduar të jetë si një kujtesë e dokumenteve që duhet të shoqërojnë çdo aplikim. Kjo do të përdoret si një listë reference për aplikuesin dhe për organizatën / autoritetin lëshues dhe për këtë arsye duhet të përdoret si faqja e parë e anekseve të formularit të aplikimit (secila kuti duhet të kontrollohet sipas rasteve specifike).

Për referencë dhe udhëzim me të lehtë, çdo fushë në formularin e aplikimit është numëruar dhe shpjeguar në faqet në vijim.

Personi i autorizuar për të miratuar kërkesën e paraqitur me Formularin e Aplikimit duhet të nënshkruajë dokumentin, në hapësirën përkatëse, dërgohet te organi i sigurisë. Emri i personit që nënshkruan do të vendoset gjithashtu.

SHPJEGIME DHE UDHËZIME PËR PËRDORIM

Në vazhdim do të japim sqarime se si duhet të plotësohet dhe çka do të thotë secila pikë e aplikacionit për certifikatë të sigurisë.

- 1.1.-1.2. Emri dhe adresa e autoritetit/organit të sigurisë të cilit i dërgohet aplikacioni. Informatat e përditësuara mund të gjinden në faqen e internetit të institucionit (www.arh-ks.org).
- 2.1. Kjo fushë duhet të specifikojë nëse Formulari i Aplikimit i dorëzuar është për Certifikatën e Sigurisë Pjesa A. Në këtë rast duhet të ofrohen informacione shtesë duke shënuar me "tik" në kutitë e mëposhtme, me qëllim të identifikimit të llojit dhe shtrirjen e shërbimeve të ndërmarrjes hekurudhore.
- 2.2. Aplikuesi duhet të zgjedhë këtë kuti në rastet e mëposhtme:
 - A) nëse aplikon për herë të parë për një Certifikatë të Sigurisë Pjesa A;
 - B) nëse certifikata e mëparshme e sigurisë, për të njëjtin lloj dhe fushë të shërbimit është revokuar;
 - C) në çdo rast tjetër që nuk mbulohet nga fushat e mëposhtme 2.3 dhe 2.4.
- 2.3. Certifikata e sigurisë do të rinovohet me kërkesën e ndërmarrjes hekurudhore në intervale kohore jo më të gjata se pesë vjet (neni 10 (5) të Direktivës 2004/49/EC).
- 2.4. Kurdoherë që lloji ose shtrirja e veprimtarisë së një ndërmarrjeje hekurudhore do të ndryshojë në mënyrë substanciale, atëherë certifikata e sigurisë duhet të përditësohet tërësisht ose pjesërisht dhe për këtë arsye është e nevojshme të kërkolet përditësim / ndryshim i certifikatës. Përveç kësaj, mbajtësi i certifikatës së sigurisë duhet të informojë pa vonesë organin kompetent për të gjitha ndryshimet kryesore në kushtet e pjesës përkatëse të certifikatës së sigurisë sa herë që në ndërmarrje është futur një kategori e re e stafit ose llojit të mjeteve lëvizëse (Neni 10 (5) të Direktivës 2004/49/EC).
- 2.5. Nëse është e aplikueshme, specifikoni numrin e plotë të numri të identifikimit të certifikatës së mëparshme të Pjesës A, në lidhje me të cilën Formulari i Aplikimit i dorëzohet autoritetit / organit të sigurisë siç ceket në fushat 1.1 dhe 1.2 të kësaj rregullore.
- 2.6.-2.7. Kur aplikoni gjithashtu / vetëm për shërbimet e udhëtarëve, duhet të specifikohet, duke shënuar në kutinë e duhur, ku sqarohet nëse operimet do të përfshijnë ose përjashtojnë shërbimet me shpejtësi të lartë: vetëm një opsion mund të zgjidhet. Megjithatë, shërbimet që i referohen opsionit të zgjedhur 2.6 ose 2.7, janë gjithashtu

gjithëpërfshirëse për çdo lloj tjetër të transportit të udhëtarëve (dmth. rajonale, të shkurtra, të mesme, në distancë të largët etj.) si dhe të çdo shërbimi tjetër të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve për pasagjerë, duke aplikuar për (operimet e tërheqjes, etj.). Definimi i shërbimeve me shpejtësi të lartë, përcaktohet në Aneksin I të Direktivës 96/48 / EC.

2.8.-2.9. Kur aplikohet për shërbimet e udhëtarëve duhet të zgjidhen pikat 2.6 ose 2.7, duke shënuar në katrorin e duhur vëllimin aktual ose të planifikuar, për sa i përket km / vit, të shërbimeve. Vetëm një opsion mund të zgjidhet. Kategoritë e shqyrtuara janë në përputhje me Rregulloren (BE) Nr 1192/2003 për statistikën e transportit hekurudhor.

2.10.-2.11. Kur aplikohet vetëm për shërbime të mallrave, duhet të specifikohet, duke shënuar kutinë e duhur, nëse operimet do të përfshijnë ose përjashtojnë transportin e mallrave të rrezikshme, vetëm një opsion mund të zgjidhet. Megjithatë, shërbimet që i referohen opsionit të zgjedhur në 2.10 ose 2.11, janë gjithashtu gjithë përfshirëse të çdo lloji tjetër të transportit të mallrave që nuk përmendet në mënyrë eksplicite, si dhe të ndonjë shërbimi tjetër të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve të mallrave që aplikojnë (operimet e tërheqjes, etj.). Për përkufizimet që kanë të bëjnë me mallrat e rrezikshme, duhet të referohemi Direktivës 96/49 / EC dhe shtojcave të saj.

Operatorët që kryejnë shërbime të transportit hekurudhor për nevojat e brendshme hekurudhore konsiderohen të jenë brenda fushës së transportit të mallrave (p.sh. kompanitë e mirëmbajtjes së linjave që transferojnë makinat e punës nga një vend në një tjetër ose kompani që operojnë trenat e matjes).

2.12.-2.13. Kur aplikoni për shërbime të transportit të mallrave duhet të shënohet në piken 2.10 ose 2.11, duke shënuar kutinë e duhur parashikimin e vëllimit aktual ose të planifikuar, në terma të ton-km në vit. Vetëm një opsion mund të zgjidhet. Kategoritë e shqyrtuara janë në përputhje dhe në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 1192/2003 për statistikën e transportit hekurudhor.

2.14. Nëse aplikuesi synon të kryejë vetëm shërbime të tërheqjes pa kryer transportin e pasagjerëve ose mallrave, kjo kuti duhet të zgjidhet.

2.15. Duke iu referuar shërbimeve të aplikuara (pasagjerëve, mallrave ose vetëm tërheqjes), caktohet data kur planifikohet që të fillohet me operim. Në rast të një certifikate të ripërtërirë ose të përditësuar / ndryshuar, duhet të përcaktohet data në të cilën certifikatën do të hyjë në fuqi dhe të zëvendësojë atë të mëparshmen.

2.16. Nëse numri i punonjësve që punojnë në sektorin hekurudhor ose të përfshirë në operime të lidhura me çështjet hekurudhore, duke përfshirë kontraktorët, është ndërmjet 0 (duke siguruar vetëm një punë për sipërmarrësin) dhe 9 persona të punësuar, duhet të zgjidhet opsioni "Mikro Ndërmarrje". Përkufizimi mbi madhësinë

e ndërmarrjeve i referohet asaj që zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme për Ndërmarrje dhe Industrisë. Mund të zgjidhet vetëm një opsion mes atyre që janë në dispozicion (2.16, 2.17, 2.18, 2.19).

- 2.17. Nëse numri i punonjësve që punojnë në sektorin hekurudhor ose të përfshirë në operime të lidhura me çështjet hekurudhore, duke përfshirë kontraktorët, janë midis 10 dhe 49 persona të punësuar, duhet të zgjidhet opsioni "Ndërmarrje e vogël". Përkufizimi mbi madhësinë e ndërmarrjeve i referohet asaj që zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme për Ndërmarrje dhe Industri. Vetëm një opsion mund të zgjidhet në mesin e atyre që janë në dispozicion (2.16, 2.17, 2.18, 2.19).
- 2.18. Nëse numri i punonjësve që punojnë në sektorin hekurudhor ose të përfshirë në operime të lidhura me çështjet hekurudhore, duke përfshirë kontraktorët, janë midis 50 dhe 249 persona të punësuar, duhet të zgjidhet opsioni "Ndërmarrje e Mesme". Përkufizimi mbi madhësinë e ndërmarrjeve i referohet asaj që zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme për Ndërmarrje dhe Industri. Vetëm një opsion mund të zgjidhet në mesin e atyre që janë në dispozicion (2.16, 2.17, 2.18, 2.19).
- 2.19. Nëse numri i punonjësve që punojnë në sektorin hekurudhor ose të përfshirë në operime të lidhura me çështjet hekurudhore, duke përfshirë kontraktorët, janë 250 ose më shumë persona të punësuar, duhet të zgjidhet opsioni "Ndërmarrje e madhe". Përkufizimi mbi madhësinë e ndërmarrjeve i referohet asaj që zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme për Ndërmarrje dhe Industri. Vetëm një opsion mund të zgjidhet në mesin e atyre që janë në dispozicion (2.16, 2.17, 2.18, 2.19).
- 3.1. Kjo fushë duhet të specifikojë nëse Formulari i Aplikimit i dorëzuar është për Certifikatën e Sigurisë Pjesa B. Në këtë rast duhet të ofrohen informacione shtesë duke shënuar me "tik" në kutitë e mëposhtme, me qëllim të identifikimit të llojit dhe shtrirjen e shërbimeve të ndërmarrjes hekurudhore.
- 3.2. Aplikuesi duhet të zgjedhë këtë kuti në rastet e mëposhtme:
- A) nëse aplikon për herë të parë ose për ndonjë tjetër Certifikatë të Sigurisë Pjesa B;
 - B) nëse certifikata e mëparshme e sigurisë, për llojin e njëjtë ose zgjerim të shërbimeve është revokuar;
 - C) në çdo rast tjetër që nuk mbulohet nga fushat e mëposhtme 3.3 dhe 3.4.
- 3.3. Certifikata e sigurisë do të rinovohet me kërkesën e ndërmarrjes hekurudhore në intervale kohore jo më të gjata se pesë vjet Ligji 04/L-063 neni 94 (8), si dhe (neni 10 (5) të Direktivës 2004/49/EC).

- 3.4. Kurdoherë që lloji ose shtrirja e veprimtarisë së një ndërmarrjeje hekurudhore do të ndryshojë në mënyrë substanciale, atëherë certifikata e sigurisë duhet të përditësohet tërësisht ose pjesërisht dhe për këtë arsye është e nevojshme të kërkohej përditësim / ndryshim i certifikatës. Përveç kësaj, mbajtësi i certifikatës së sigurisë duhet të informojë pa vonesë organin kompetent për të gjitha ndryshimet kryesore në kushtet e pjesës përkatëse të certifikatës së sigurisë sa herë që në ndërmarrje është futur një kategori e re e stafit ose llojit të mjeteve lëvizëse (Neni 10 (5) të Direktivës 2004/49/EC).
- 3.5. Nëse është e aplikueshme, specifikoni numrin e plotë të numrit të identifikimit të certifikatës së mëparshme të Pjesës B, në lidhje me të cilën Formulari i Aplikimit i dorëzohet autoritetit / organit të sigurisë siç ceket në fushat 1.1 dhe 1.2 të kësaj rregullore.
- 3.6.-3.7. Njëjtë si në 2.6, 2.7 (Shiko me lartë)
- 3.8.-3.9. Njëjtë si në 2.8, 2.9 (Shiko me lartë)
- 3.10.-3.11. Njëjtë si në 2.10, 2.11 (Shiko me lartë)
- 3.12.-3.13. Njëjtë si në 2.12, 2.13 (Shiko me lartë)
- 3.14. Njëjtë si në 2.14 (Shiko me lartë)
- 3.15. Njëjtë si në 2.15 (Shiko me lartë)
- 3.16. Certifikata e Sigurisë Pjesa B mund të mbulojë të gjithë rrjetin hekurudhor ose vetëm një pjesë të caktuar (Neni 10 (1) të Direktivës 2004/49/EC), është e nevojshme që të specifikohen në mënyrë të qartë të gjitha linjat në të cilat do të ofrohen shërbimet e operimit (pasagjer, mallra apo vetëm tërheqje). Emërtimi / emrat e linjave janë dhënë në 'Deklaratën e Rrjetit' (referojuni Nenit 3 dhe Shtojca I të Direktivës 2001/14 / KE), ndërmarrjet hekurudhore duhet të ju referohen linjave që përdorin këto emërime / emra. Nëse hapësira në dispozicion nuk është e mjaftueshme, aplikuesi mund të ofrojë anekse të Formularit të Aplikimit dhe përdorin këtë fushë për t'i specifikuar ato.
- 3.17. Ky informacion duhet të jepet vetëm nëse aplikuesi po aplikon për një Certifikatë të Sigurisë Pjesa B, të re, rinovuar ose të përditësuar / ndryshuar dhe tashmë ka një Certifikatë të Sigurt të Pjesës A. Numri i Identifikimit jepet nga çdo autoritet / organ i cili i lëshon në bazë të rregullave të përcaktuara. Informacioni i dhënë këtu nuk e përjashton aplikuesin që të dorëzojë një kopje të Certifikatës së Sigurisë Pjesa A së bashku me kërkesën për aplikim pika (8.1) e kësaj rregullore. Nëse një numër identifikimi ende nuk është i disponueshëm, atëherë në kuti e shkruani 'nuk zbatohen'.

- 3.18. Këtu duhet të përcaktohet shteti që ka lëshuar Certifikatën e Sigurisë Pjesa A (Shteti i autoritetit / organit që e lëshon certifikatën). Informacioni i dhënë këtu nuk e përjashton aplikuesin që të dorëzojë një kopje të Certifikatës së Sigurisë Pjesa A së bashku me kërkesën për aplikim pika (8.1) e kësaj rregullore.
- 4.1. Ky informacion duhet të jepet vetëm në rast se aplikuesi ka një ose më shumë Certifikata të Sigurta të Sigurisë Pjesa B. Duhet të përcaktohet numri evropian i identifikimit të Certifikatës të lëshuar Pjesa B, duke e ndarë atë me '/' nëse kemi rastin kur zbatohet. Nuk është e nevojshme që aplikuesi të paraqesë një kopje të Certifikatës së Sigurisë Pjesa B së bashku me kërkesën.
- 4.2. Ky informacion duhet të jepet vetëm nëse aplikohet për Pjesën A dhe / ose Pjesën B, në rastin kur ndërmarrja hekurudhore tashmë ka një Licencë të vlefshme (Direktiva e Këshillit 95/18 / EC e ndryshuar me Direktivën 2001/13 / EC). Informacioni i dhënë nuk e përjashton aplikuesin nga dorëzimi i një kopje të Licencës së bashku me aplikimin (7.2 dhe 8.2).
- SHENIM: Një ndërmarrje hekurudhore, siç përcaktohet në Direktivën 2001/14 / EC, duhet të licencohet sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë, megjithatë një ndërmarrje hekurudhore, siç përcaktohet në Direktivën 2004/49 / EC, nuk kërkohet gjithmonë që të ketë licencë Ligji 04/L-063 neni 48 (3).
- 4.3. Këtu duhet të përcaktohet shteti që ka lëshuar Licencën (Shteti i autoritetit / organit që e ka lëshuar). Informacioni i dhënë këtu nuk përjashton aplikuesin nga dorëzimi i një kopje të Licencës së bashku me kërkesën (7.2 dhe 8.2).
- 5.1. Nëse emërtimi Ligjor ndryshon nga emri i ndërmarrjes hekurudhore atëherë të dy emërtimet duhet të përfshihen.
- 5.2.-5.2. Çdo aplikant duhet të ofrojë informacionin e nevojshëm për ti mundësuar organit që e lëshon certifikatën të kontaktojë ndërmarrjen hekurudhore (numrat e telefonit por jo numrin e personit përgjegjës për procesin e certifikimit; numrat e telefonit dhe faksit duhet të përfshijnë Kodi i vendit, adresa e e-mailit, kutinë e postës së përgjithshme të ndërmarrjes hekurudhore). Informacioni kontaktues i ndërmarrjes hekurudhore duhet të tregojë adresën e përgjithshme duke shmangur referencat ndaj një personi të caktuar, pasi ky informacion mund të futet në pikat 6.1 deri në 6.5. Specifikimi i faqes së internetit (5.8) nuk është i detyrueshëm.
- 5.9.-5.10. Nëse janë dhënë disa numrat e regjistrimit të ndërmarrjes hekurudhore atëherë ka mundësi në formularin e aplikimit të vendoset numri i TVSH-së (5.10) dhe numri i regjistrimit të dytë (5.9) (p.sh regjistrin tregtar).

- 5.11. Informacion tjetër përveç atij që kërkohet qartë në fushat e tjera, mund të shtohet nëse është e nevojshme.
- 6.1.-6.5. Gjatë gjithë procesit të certifikimit, personi i kontaktit është ndërlidhja ndërmjet ndërmarrjes hekurudhore që paraqet kërkesën dhe organit / autoritetin që e lëshon certifikatën. Ai / ajo siguron mbështetje, ndihmë, informacion, sqarime, kur është e nevojshme, si dhe është pikë referuese për organin lëshues që merret me shqyrtimin e kërkesës. Numrat e telefonit dhe faksit duhet të përfshijnë kodin e vendit; adresa e postës elektronike nuk është e detyrueshme të shkruhet.
- 7.1. Ky dokument duhet të dorëzohet nëse aplikohet për Certifikatë të Sigurisë Pjesa A (certifikatë e re, rinovuar ose përditësuar / ndryshuar). Përmbledhja e manualit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (SMS), është menduar si një dokument që shqyrton dhe nënvizon elementët kryesore të SMS-së të ndërmarrjes hekurudhore. Ky manual duhet të detajojë dhe të japë informacion mbështetës dhe evidencë të proceseve të ndryshme ose standardeve / rregullave të ndërmarrjeve hekurudhore të cilat zbatohen (ose janë në fazën e zbatimit), referencat ndërlidhura ose që lidhen me pikat e identifikuar në Nenin 9 dhe Aneksin III të Direktivës 2004/49/KE.
- 7.2. Një ndërmarrje hekurudhore, siç përcaktohet në Direktivën 2001/14 / KE, duhet të jetë e licencuar sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë. Megjithatë, në Direktivën 2004/49 / KE, përcaktohet se një ndërmarrje hekurudhore nuk kërkohet të ketë licencë, prandaj ndërmarrja hekurudhore duhet të dorëzojë një kopje të licencës së vlefshme vetëm nëse ky rast zbatohet. Nëse nuk zbatohet opsioni atëherë duhet të zgjidhet opsioni "Nuk aplikohet" (7.3 dhe / ose 8.3).
- 7.3. Referoju 7.2.
- 8.1. Nëse në Formular të Aplikimit aplikohet vetëm për Certifikatën e Sigurisë Pjesa B (certifikatë e re, rinovuar ose përditësuar / ndryshuar), por jo edhe për Certifikatën e Sigurisë Pjesa A, atëherë duhet të dorëzohet kopja e një Certificate të Sigurisë të Pjesës A.
- 8.2. Njëjtë si në 7.2 (shih më lartë).
- 8.3. Njëjtë si në 7.3 (shih më lartë).
- 8.4. Sipas nenit 9 të Direktivës 95/18 / KE-së një ndërmarrje hekurudhore duhet të sigurohet në mënyrë adekuate ose të bëjë marrëveshje ekuivalente (p.sh. një garancion financiarë) për mbulimin e dëmeve, në përputhje me të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare, të detyrimeve të saj në rast aksidenteve. Dëshmia se një ndërmarrje hekurudhore e licencuar është në përputhje me kërkesat kombëtare në lidhje me sigurimin ose ka bërë marrëveshje ekuivalente për mbulimin e detyrimeve të saj i

bashkëngjitet licencës (Rekomandimi i Komisionit 2004/358 / KE). Një kopje e sigurimit ose e mbulimit financiar për përgjegjësinë e bashkëngjitur në licencë duhet të dorëzohet me Formularin e Aplikimit.

- 8.5. Aplikuesi duhet të listojë ose dorëzojë dokumentacionin mbi TSI-të ose pjesë të TSI-ve, kur është e përshtatshme edhe të rregullave kombëtare të sigurisë dhe rregullave të tjera të zbatueshme për stafin, mjetet lëvizëse dhe në përgjithësi për shërbimet që synohet të ofrohen me certifikatën e kërkuar . Referenca e qartë duhet t'i bëhet proceseve dhe dokumenteve ku TSI-të janë të aplikueshme dhe zbatohen. Për të shmangur dyfishimin e punës dhe për të zvogëluar sasinë e informacionit, vetëm dokumentacion përmblledhës duhet të dorëzohet në lidhje me elementet që përputhen me TSI-të dhe kërkesat e tjera të Direktivave 96/48 / EC dhe 2001/16 / KE-së.
- 8.6. Aplikuesi duhet të paraqesë një listë të plotë të kategorive të ndryshme të personelit të punësuar ose të kontraktuar për shërbimet që synojnë të operojnë me certifikatën e kërkuar. Lista e kategorive të stafit duhet të jetë në përputhje me rregullat veçanta kombëtare dhe me rregullat e veçanta të rrjetit të cilat aplikohen për kategorizimin e tyre.
- 8.7. Aplikuesi duhet të paraqesë një përshkrim ose dëshmi të atyre proceseve brenda Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (SMS) që kanë të bëjnë me personelin, duke përfshirë dëshminë se ato i plotësojnë kërkesat e rregullave kombëtare dhe / ose TSI-ve përkatëse dhe se personeli është i certifikuar.
- 8.8. Aplikuesi duhet të dorëzojë një dokumentacion të plotë për Llojet e mjeteve lëvizëse të cilat mendojnë që ti përdorin për të operuar me certifikatën e kërkuar. Llojet e mjeteve lëvizëse duhet të jenë në përputhje me rregullat kombëtare dhe me rregullat e veçanta të rrjetit të cilat aplikohen për kategorizimin e tyre.
- 8.9. Aplikuesi duhet të paraqesë një përshkrim ose dëshmi të atyre proceseve brenda Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (SMS) që kanë të bëjnë me Mjetet Lëvizëse, duke përfshirë dëshminë se ato i plotësojnë kërkesat e rregullave kombëtare dhe / ose TSI-ve përkatëse dhe se mjetet lëvizëse janë autorizuar siç parashihet.
- 8.10. Hapësirë e nevojshme për të specifikuar dokumentet e tjera të dorëzuara me aplikacion. Nëse ka dokumente shtesë atëherë duhet të identifikohet numri dhe lloji, së bashku me një përshkrim të shkurtër të përmbajtjes së dokumentit.

SHTOJCA IV

Kodi i harmonizuar për sistemin e numërimit, i quajtur Numri Evropian Identifikues (EIN-European Identification Number), për Certifikatat e Sigurisë

Kodi shtetëror (2 shkronja)		Lloji i dokumentit (2 numra)		Viti i lëshimit (4 numra)				Numri rendor (4 numra)			

Shembull: Pasi që Kosova nuk është anëtare e Unionit Ndërkombëtar të Hekurudhave (UIC), si dhe Kosova nuk ka një Kod Shtetëror të ndarë nga unioni i cekur më lartë, ne për nevoja të brendshme kemi përdorur si Kod shtetëror alternativ KS.

Kodi shtetëror (2 shkronja)		Lloji i dokumentit (2 numra)		Viti i lëshimit (4 numra)				Numri rendor (4 numra)			
K	S	1	1	2	0	1	8	0	0	0	1

Sqarime për Numrin Evropian Identifikues (EIN)

Kodi shtetëror (2 shkronja)		Lloji i dokumentit (2 numra)		Viti i lëshimit (4 numra)				Numri rendor (4 numra)			
K	S	1	1	2	0	1	8	0	0	0	1

Fusha 1

Fusha 2

Fusha 3

Fusha 4

FUSHA 1 – Kodi shtetëror (2 shkronja)

Kodet e vendit janë ato që publikohen zyrtarisht dhe përditësohen në Ueb faqen evropiane, në udhëzuesin ndërinstitucional dhe bazohen në standardin ISO 3166 alpha-2.

Shteti	Kodi
Shqipëria	AL
Austria	AT
Belgjika	BE
Bullgari	BG
Qipro	CY
Republika Çeke	CZ
Danimarka	DK
Estonia	EE
Finlanda	FI
Franca	FR
Gjermania	DE

Shteti	Kodi
Greqia	EL
Hungaria	HU
Islanda	IS
Irlanda	IE
Italia	IT
Letonia	LV
Lihtenshtajni	LI
Lituania	LT
Luksemburgu	LU
Norvegjia	NO
Malta	MT

Shteti	Kodi
Holanda	NL
Polonia	PL
Portugalia	PT
Rumania	RO
Republika Sllovake	SK
Sllovenia	SI
Spanja	ES
Suedia	SE
Zvicra	CH
Mbretëria e Bashkuar	UK

FUSHA 2 – Lloji i dokumentit (2 numra)

Dy numra që mundësojnë identifikimin e llojit të dokumentit: numri i parë identifikon klasifikimin e përgjithshëm të dokumentit, nëse është Certifikatë e Sigurisë (numri 1) ose çdo lloj tjetër dokumenti (numër i ndryshëm nga 1); shifra e dytë specifikon nëntipin e dokumentit, nëse është një Certifikatë Pjesa A (numër 1) ose Pjesa B (numër 2). Tani për tani, është e mundur që kombinimet në numra do të reflektojnë vetëm dy raste të përdorimit:

[1 1] – për Certifikatë të Sigurisë - Pjesa A;

[1 2] – për Certifikatë të Sigurisë - Pjesa B;

Me nevojën për kodet e tjera ky sistem numërimi mund të zgjatet. Në vijim është lista e propozuar, e kombinimeve të mundshme të numrave dy shifrorë në lidhje me llojin e dokumentit i cili shqyrtohet apo merret në konsideratë:

Kombinimi i numrave për fushën 2	Lloji i dokumentit	Nëntipi i dokumentit
[0 1]	Licenca	Nuk aplikohet për këtë rregullore
[0 x]	Licenca	Nuk aplikohet për këtë rregullore
[1 1]	Certifikata e Sigurisë	Pjesa A
[1 2]	Certifikata e Sigurisë	Pjesa B
[1 x]	Certifikata e Sigurisë	Nuk aplikohet për këtë rregullore
[2 1]	Autorizimi i Sigurisë	Nuk aplikohet për këtë rregullore
[2 2]	Autorizimi i Sigurisë	Nuk aplikohet për këtë rregullore
[2 x]	Autorizimi i Sigurisë	Nuk aplikohet për këtë rregullore
[3 x]	Certifikata për mirëmbajtje	Nuk aplikohet për këtë rregullore
[4 x]	Certifikata për organet njoftuese	Nuk aplikohet për këtë rregullore
[5 x]... [9 x]	Rezervë (5 lloje të dokumenteve)	Nuk aplikohet për këtë rregullore

FUSHA 3 – Viti i lëshimit (4 numra)

Kjo fushë tregon vitin (në formatin e caktuar, dmth. 4 shifra) në të cilën është lëshuar certifikata.

FUSHA 4 – Numri rendor (4 numra)

Numri rendor është një numër progresiv që rritet për një njësi secilën herë që lëshohet një certifikatë, pavarësisht nëse është një certifikatë e re, e rinovuar ose e përditësuar / e ndryshuar. Në rast të revokimit të një certifikate, numri i cilit i referohet nuk mund të përdoret përsëri.

Çdo vit numërimi do të rifillojë nga zero.